

**URDHËR**  
**Nr. 642, datë 13.11.2023**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR  
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, GJIMNAZI “UNIVERSI” BALLSH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të urdhrit nr. 565, datë 5.10.2023, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Nina Guga”,

**URDHËROJ:**

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh, të subjektit juridik Glavenica, sh.p.k., me NIPT: K17710805A, të cilit i është dhënë leja e funksionimit me urdhrin nr. 194, datë 17.07.2002, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar”, me kërkesën e tij nr. 23110 prot., datë 23.10.2023.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh, ka për detyrë:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Mallakastër, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

b) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Mallakastër, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur, nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Mallakastër, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh.

b) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

c) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve, nga institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh, të përcaktuara në pikën 2, të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 194, datë 17.7.2002, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik parauniversitar”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Mallakastër, institucioni arsimor parauniversitar privat, Gjimnazi “Universi” Ballsh.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**Nina Guga**